



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore për krime lufte, *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, më 24 janar Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes për leje për apelim të një vendimi të mëparshëm, në të cilin Trupi Gjykses lejoi Prokurorinë të përdorte gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari një material që nuk ishte në listën e provave materiale në kohën e pyetjeve shtesë.

Trupi Gjykses rikujtoi konstatimin e vet se pyetjet shtesë të Prokurorisë u bazuan në faktin se dokumenti mori një rëndësi të re pas marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Mbrojtja. Për shkak të llojit reagues të pyetjeve shtesë, Trupi Gjykses konstatoi se pala thirrëse lejohet të përdorë dokumente që nuk janë në listën e provave materiale, me kusht që ato të jenë nxjerrë për Mbrojtjen mjaftueshëm në kohë dhe nuk ndikojnë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit.

Më 28 janar, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar një apel të ardhshëm të z. Veseli dhe z. Krasniqi kundër një urdhri gojor të Trupit Gjykses. Në këtë urdhër, Trupi Gjykses hodhi poshtë kundërshtimin e z. Veseli se gjatë pyetjeve të gjykatësve për dëshmitarin, Trupi Gjykses përdori transkriptin e një interviste të Prokurorisë me një person që Prokuroria kishte vendosur të mos e thërriste për të dhënë dëshmi. Paneli i Gjykatës së Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Këtë javë, katër dëshmitarë dhanë dëshmi në gjykatë që nga përditësimi i fundit. Helmut Shreckenbauer (Helmut Schreckenbauer) ishte mjek në kuadër të KFOR-it gjerman në Kosovë midis qershorit dhe gushtit 1999. Patologu ligjor Marek Gasior dha





dëshmi si dëshmitar ekspert. Ai ka dhënë dëshmi edhe më parë në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*. Naser Krasniqi ishte anëtar i UÇK-së. Zotit Krasniqi iu caktua një mbrojtës për ta ndihmuar dhe udhëzuar në lidhje me aspekte të vetinkriminimit të mundshëm. Trupi Gjykues e siguroi dëshmitarin se dëshmia e tij nuk do të përdorej kundër tij në ndjekje penale të mëvonshme para Dhomave të Specializuara. Sipas Prokurorisë, dëshmitari që filloi dhënien e dëshmisë sot, u rrëmbye në vitin 1999 nga burra të armatosur që mbanin uniforma me emblema të UÇK-së dhe u mbajt i ndaluar e u keqtrajtua në disa vende. Ai u lirua në vijim të negociatave me KFOR-in. Dëshmitari dha dëshmi me masa mbrojtëse dhe me videolidhje. Shumica e dëshmive u dhanë kryesisht në seanca publike.

Deri më sot 119 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në gjykatë në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 10 shkurt, duke filluar në orën 9 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi* për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, më 24 janar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për zgjatje të afatit për ekipet e Mbrojtjes për dorëzim të mocioneve paraprake deri më 4 mars 2025.

Sipas Rregullores i akuzuari mund të paraqesë mocione, për shembull, në lidhje me kundërshtim ndaj juridiksionit të Dhomave të Specializuara, pretendim për mangësi në aktakuzë, ose të kërkojë që një i akuzuar të gjykohet veçazi dhe jo bashkërisht me të tjerët. Rregullorja përcakton se këto mocione paraprake duhet të dorëzohen brenda 30 ditësh pasi Prokuroria të ketë nxjerrë për Mbrojtjen të gjitha provat në të cilat mbështetet aktakuza. Afati i parë ishte më 7 shkurt 2025.

Më 27 janar 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim ku konstatoi se nuk ka konflikt interesash aktual ose të mundshëm nga caktimi i Dejvid Jang (David





Young) si Mbrojtës i z. Fazliu. Zyra Administrative e DHSK-së kishte kërkuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake që të vendoste nëse caktimi mund të çonte në ndonjë konflikt interesash të mundshëm, duke pasur parasysh se z. Jang ishte më parë Mbrojtës i z. Selimi në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* dhe duke pasur parasysh se veprat penale për të cilat akuzohet z. Fazliu përfshijnë ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve që japin dëshmi në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se nuk ka ngjashmëri sa i përket kuadrit të akuzave në dy çështjet gjyqësore dhe mori parasysh faktin që z. Jang nuk është më Mbrojtës i z. Selimi. Paneli vuri në dukje gjithashtu se z. Jang kishte marrë pëlqimin e z. Selimi dhe z. Fazliu.

Në të njëjtin vendim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Fazliut për zgjatje të afatit për t'iu përgjigjur të gjitha parashtrimeve. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se argumenti i Mbrojtjes se zgjatja e afatit nevojitej për shkak se z. Fazliu u privua nga përfaqësimi juridik nuk pasqyronte realitetin dhe rikujtoi se z. Fazliu u përfaqësua nga mbrojtësi kujdestar gjatë gjithë kohës dhe si rrjedhojë pati mundësinë t'iu përgjigjej parashtrimeve.

Më 28 janar, Paneli i Apelit hodhi poshtë apelin e Isni Kilajt kundër vendimit gojor të Gjykatësës së Procedurës Paraprake të 9 dhjetorit që urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj. Paneli konstatoi se z. Kilaj nuk demonstroi se vlerësimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake nuk ishte i drejtë dhe i arsyeshëm se vazhdojnë të ekzistojnë disa rreziqe që përlligjin vazhdimin e paraburgimit. Paneli i Apelit urdhëroi z. Kilaj të dorëzonte versionin e redaktuar publik të apelit të tij.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, më 24 janar, Trupi Gjykues urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Ismet Bahtijarit. Trupi Gjykues konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Bahtijari mund të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejë vepra penale të tjera, veçanërisht duke pasur parasysh se ai ka mjetet dhe motivin për të ushtruar trysni ndaj dëshmitarit 1 për ta bindur atë që të mos marrë pjesë në proces.





Më 28 janar, Mbrojtja e Pjetër Shalës dorëzoi Njoftimin për Apelim të Urdhrit për Zhdëmtim. Dokumenti është i disponueshëm në faqen e internetit të DHSK-së.

